Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Fakulteti i Edukimit

Departamenti i Mësuesisë

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Edukimi dhe Lidershipi

"Probleme të arsimimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kushtet e pandemisë Covid-19."

Autore: Lidia Reçi

Arsim Fillor, viti i tretë Bachelor.

Tiranë 2021

Lidia Reçi

Fakulteti i Edukimit
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Probleme të arsimimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kushtet e pandemisë Covid-19

Abstrakti

Arsimi është padyshim një nga fushat më të prekura prej pandemisë Covid-19. Përveç se u gjend fillimisht i papërgatitur për një situatë që do të ndryshonte rrënjësisht mësimdhënien e mësimnxënien, edhe më vonë problematikat që shoqëruan edukimin online ishin të mprehta dhe në shumë raste të vështira për t'u zgjidhur. Këto problematika ishin më serioze, sidomos për Shqipërinë, një vend me probleme sociale, ekonomike etj., dhe që me krizën prej pandemisë u thelluan dhe më shumë. Pandemia, në fakt, i preku të gjitha shtresat e nxënësve, të gjitha grupmoshat, familjet e tyre. Po nëse për një kategori nxënësish, pjesë e familjeve me të ardhura të konsiderueshme, përballimi i krizës ishte më i lehtë, për kategori të tjera, kjo krizë ndikoi drejtpërdrejt në përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes së tyre. Komuniteti rom dhe egjiptian është një prej këtyre grupeve. Si pakica lehtësisht të cenueshme si rrjedhojë e një papunësie të theksuar, burimeve të pamjaftueshme financiare, nivelit të ulët të arsimimit, paragjykimit dhe mungesës së informimit mbi mbështetjen sociale nga ana e insitucioneve përkatëse, ky grup u përball me një pengesë të re: arsimimin online. Ky punim synon të analizojë problemet kryesore që hasi komuniteti rom dhe egjiptian kundrejt qasjes në arsim në kushtet e pandemisë COVID-19, parë në kornizën e statusit socio-ekonomik, të kulturës, mendësive, modeleve prindërore dhe integrimit gjinor, si faktorë ndikues të pjesëmarrjes ose braktisjes së arsimimit të detyrueshëm përgjatë kësaj kohe të përshkuar nga kriza. Analizat janë bërë përmes metodave cilësore të hulumtimit. Krahas rishikimit të literaturës referuar studimeve për këtë komunitet dhe mësimdhënies online në vendin tonë gjatë pandemisë, u përdorën pyetësorë e intervista gjysmë të strukturuara në varësi të aftësive për shkrim ose lexim, për të parë nga afër perceptimet e tyre mbi këtë situatë.

Pyetësorët dhe intervistat u kryen në 32 familje me përkatësisht 53 prindër dhe 122 fëmijë të grupmoshës 6-16 vjeç. Rezultatet e këtij punimi nxjerrin në pah pamundësinë e fëmijëve të familjeve rome e egjiptiane për arsimimin online. Po ashtu, nga studimi i kryer rezulton se një numër i konsiderueshëm fëmijësh të këtyre komuniteteve e kanë braktisur shkollën ose nuk janë regjistuar fare në këtë vit të ri shkollor, si pasojë e vështirësive të theksuara lidhur me arsimin online ose procedurat e regjistrimit përmes portalit e-Albania.

Fjalë kyç: komuniteti rom dhe egjiptian, COVID-19, mësim online, brakstisje, arsim gjithpërfshirës.

Hyrje

Shoqëritë janë diverse dhe përbëhen nga shtresa të ndryshme shoqërore, të cilat kanë nevojë për arsim të përshtatur sipas nevojave dhe kulturës së tyre (Zacellari et al., 2018). Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit qëndrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë ku sipas së cilës, çdo individ gëzon të drejtat dhe liritë e përcaktuara pa asnjë kufizim përsa i përket racës, gjuhës, origjinës, përkatësisë në një minoritet kombëtar, ose çdo statusi social, ekonomik apo arsimor (Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2017-2020).

Mirëpo shpesh grupet e pakicave në shoqëritë bashkëkohore përballen me problemin e arritjes së barazisë arsimore me grupet dominuese të shoqërive në të cilat bashkëveprojnë (Ogbu, 1990). Kjo përballje u bë akoma më e vështirë gjatë pandemisë COVID-19 në vendin tonë, ku sipas një studimi të realizuar afro një vit më parë, mbyllja e shkollave, izolimi i fëmijëve dhe mësimi online ka qenë një situatë kritike e cila u shfaq më e rënduar për komunitetet vulnerabël. Në komunitetin rom rreth 95% e prindërve të anketuar kanë pohuar se fëmijët e tyre nuk kanë patur mundësi të ndjekin mësimin online. Edhe mësuesit kanë konfirmuar se mbi 80% e fëmijëve romë nuk e kanë ndjekur fare mësimin gjatë kësaj periudhe (Save the children, 2020).

Niveli i arsimimit të popullsisë rome, dhe në një masë më të vogël egjiptiane, është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë. Sipas një tjetër studimi, evidentohet fakti se në disa xhepa të izoluar të Tiranës niveli i analfabetizmit dhe braktisja e shkollës tek fëmijët e grupmoshës 8-15 vjeç është shumë e lartë, si në Shkozë, ku 60% e fëmijëve janë analfabetë dhe 20% kanë braktisur shkollën. Ja përse arsimimi i anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian, duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat më efikase për integrimin e tyre të plotë në shoqëri (Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2017-2020).

Një hap i parë për të kuptuar dështimin relativ të pjesëmarrjes në shkollë përgjatë më shumë se një viti të këtyre nxënësve, është njohja e tyre nga afër dhe ballafaqimi me kushtet e integrimit në shoqëri, me në fokus arsimin bazë e të detyruar. Në këtë mënyrë arrihet drejt përfundimeve se përse anëtarët e këtyre komuniteteve të prekur nga pengesa të ndryshme ekonomike, kulturore, gjuhësore dhe shpesh të diskriminuar në shoqëri, patën pjesëmarrje jo të kënaqshme në shkollë përgjatë pandemisë COVID-19.

Rishikimi i literaturës

Korniza social-ekonomike

Për shumë fëmijë, shanset për sukses akademik zvogëlohen për shkak të varfërisë (Altschu, 2012). Pabarazia ekonomike dhe sociale ndërlikohet nga dallimet etnike duke qenë se këto pakica janë shpesh më të varfërit nga të varfërit e madje edhe brezat e reja priren të bien në varfëri (Rega, 2016). Kjo pabarazi ekziston kur kur ka një disproporcion midis përqindjes së një grupi racor të një popullsie dhe pjesës tjetër të tij në burimet ekonomike dhe pozicionet e tjera sociale. Këto dallime vijnë në formën e padrejtësisë racore ku zakonisht ka pasoja serioze për të diskriminuarit (Matthew, 2017).

Nga kërkimet në literaturën e rritjes së statusit në shoqëri, që fokusohet në mënyrën sesi formësohen aspiratat në kuadër të pamundësive, Kao & Tienda (1998) ngrenë një hipotezë e cila pohon se dallimet racore dhe etnike në aspiratat arsimore thjesht reflektojnë pabarazitë socio-ekonomike midis të rinjve pakicë dhe jopakicë. Gjithashtu

Ewert (2014) thekson se nxënësit e pakicave dhe me të ardhura të ulëta priren të kenë përfshirje më të ulët arsimore sesa studentët e bardhë dhe më të pasur.

Komuniteti Rom dhe Egjiptian është nga komunitetet me shkallën më të lartë të varfërisë. Sipas një studimi rezulton se 77.7% e familjeve rome dhe 84.1% e atyre egjiptiane bëjnë pjesë në grupin "shumë të varfër". Ky komunitet karakterizohet nga një nivel i lartë papunësie, pa sigurime shoqërore dhe në informalitetet ekstrem me nivel të ulët arsimor (Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2017-2020).

Një nga sfidat kryesore në ofrimin e mësimit online gjatë pandemisë COVID-19 është disponueshmëria e tij për të gjitha shtresat shoqërore drejt përfshirjes në arsim. Gjatë zhvillimit të mësimit online, grupet e cenueshme si fëmijët romë dhe egjiptianë, u lanë jashtë fokusit të të mësuarit në sigurimin e lehtësive financiare për të përballuar këtë formë të re të mësimdhënies (Zaçellari & Miço, 2020).

Sipas studimit nga Save the Children (2020) 75% nga prindërit/kujdestarët romë gjatë pandemisë janë të shqetësuar nga vështirësitë për të përmbushur nevojat e fëmijëve për ushqim. Vetëm 23% e prindërve/kujdestarëve romë mund të përdorin energji elektrike ose internet, 74% e romëve mund të gëzojnë vetëm furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike, vetëm 19% e prindërve/kujdestarëve romë konfirmojnë se fëmijët e tyre mund të ndjekin mësimet gjatë izolimit, ndërsa 3⁄4 e prindërve/kujdestarëve romë e kanë të vështirë të identifikojnë të paktën një mënyrë për të lehtësuar aksesin e fëmijëve të tyre në mësime, sepse u mungojnë mjetet e duhura të komunikimit.

Korniza kulturore (mendësitë, modelet prindërore dhe dimensioni i integrimit gjinor)

Fjala "kulturë" lidhet me zhvillimin e intelektit nëpërmjet edukimit, transmetimin dhe shtresimin social, formimin kulturor dhe me arsimin si një komponent përfundimtar të konceptit (Stevens, 2014). Edhe pse debatet janë komplekse, arritjet arsimore lidhen me mënyrën sesi orientimet kulturore të grupeve të caktuara etnike promovojnë ose dekurajojnë arritjet akademike (Kao & Tienda, 1998).

Ogbu (1990) gjithashtu shpjegon se prej një periudhe të gjatë kohore pakicat kombëtare nuk janë shpërblyer në mënyrë adekuate për arritjet e tyre arsimore. Sipas tij, mendësitë e pakicave theksojnë përdorimin e mjeteve të tjera përveç shkollimit, të tilla si punësimi ose krijimi i hershëm i familjeve, e këto strategji alternative ose "mbijetese" duket se ndikojnë negativisht në ndjekjen e arsimit dhe në besimin tek institucionet vendore. Edhe sipas Grant & Hallman (2008) ekziston një lidhje e fuqishme midis përfshirjes arsimore, moshës kur kryhen martesat dhe lindjes në moshë të hershme të fëmijëve.

Studime të tjera të kryera me fëmijë dhe të rinj të që u përkasin minoriteteve tregojnë se efektet e praktikave dhe stileve të prindërimit në rezultatet akademike ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga raca, etnia dhe mjedisi sociokulturor. Disa studiues pretendojnë se fëmijët e familjeve minoritare, sidomos ata me ngjyrë, priren të dështojnë në shkollë sepse ata dhe familjet e tyre kanë probleme të brendshme që pengojnë procesin e të mësuarit. Praktikat e dobëta të prindërimit dhe dështimi për të vlerësuar arsimin shkaktojnë probleme në arritjet arsimore e po ashtu edhe probleme të tjera sociale (Prins et al., 2008).

Vlen për t'u përmendur edhe arsimimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në dimensionin e integrimit gjinor. Sipas "Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës" shumë vajza e braktisin shkollën për shkak se prindërit i martojnë në moshë vogël duke i privuar nga e drejta e shkollimit. Për më tepër, plani pranon faktin se vajzat rome dhe egjiptiane kanë më shumë gjasa të ndihen të diskriminuara dhe të përjashtuara për shkak të racës dhe të gjinisë (2017-2020).

Përpos barrierave kulturore të lartpërmendura, një pengesë tjetër lidhur me mendësinë rome dhe egjiptiane është fitimi i kompetencave digjitale, kompetencë në mungesë të së cilës sipas Zaçellari & Miço (2020), mësimi në distancë nuk mund të zbatohet. Kjo mbështetet edhe nga studimi i Save the Children (2020) që nxjerr në pah se përveç televizorit fëmijët romë përdorin dy herë më pak pajisje sesa bashkëmoshatarët e tyre, duke penguar aksesin e fëmijëve në arsim.

Korniza e diskriminimit racor

Në Konventën e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, termi 'diskriminim racor' do të thotë çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë bazuar në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare apo etnike, që është i qëllimshëm, ose pengimi i ushtrimit, në baza të barabarta, i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në çdo fushë tjetër të jetës (Mercat-Bruns et al., 2016).

Të gjitha format e racizmit janë të ndikuara nga supozime dhe steriotipe të fuqishme të cilat mundësojnë që strukturat shkollore të përjetësojnë pabarazitë racore si një sfidë dinamike dhe interaktive në arsim (Thompson, 2010).

Ka edhe raste kur mësuesit shfaqin diskriminim të fshehur ndaj fëmijëve kur fëmijët janë me ngjyrë. Nuk ka mësues të kualifikuar me origjinë rome në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, ndërsa në kurrikulën e trajnimit të mësuesve nuk i kushtohet vëmendje romëve si pjesë integrale e historisë dhe kulturës shqiptare (Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës, 2017-2020).

Diskriminimi racor, përpos vështirësive të tjera me të cilat u përballën këto komunitete gjatë pandemisë COVID-19, mbetet një faktor ndikues i cili përforcon të gjithë faktorët e tjerë socialë, ekonomikë ose kulturorë me të cilët shoqërohet në kontekstin e arsimit. Edhe studimi i Save the Children (2020) konfirmon rritje të rrezikut të diskriminimit gjatë pandemisë duke qenë se ka shumë gjasa që izolimi të ketë shkaktuar diskriminim, kryesisht në Shkodër, Berat, Kukës dhe Vlorë ku komuniteti rom përmendet si grupi më i diskriminuar nga 67% e profesionistëve.

Braktisja si rezultat i kornizës social-ekonomike, kulturore dhe diskriminimit

Braktisja e shkollës nuk shpërndahet në mënyrë të barabartë racore dhe vihet re se fëmijët që u përkasin pakicave kombëtare kanë më shumë gjasa të shkojnë drejt braktisjes së shkollës se fëmijët e tjerë (Kao & Thompson, 2003).

Ripke & Crosby (2002) tregojnë se këta fëmijë vuajnë nga ana akademike duke qenë se braktisin arsimin pa përfunduar as atë bazë, të detyruar vetëm për të punuar me paga të

ulëta ose për t'iu përkushtuar familjes, duke ulur kështu ndjeshëm shkallën e mirëqënies së pakicës së cilës i përkasin në tërësi.

Në Planin e Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës (2017-2020), theksohet se këta fëmijë përjetojnë një sërë problemesh emocionale dhe paragjykimesh, për shkak se rikthimi në po të njëjtën klasë që kanë braktisur vite më parë (mosha mendore) nuk përkon me moshën e tyre fizike. Të ndodhur përballë një fenomeni të tillë, ata detyrohen të braktisin shkollën brenda një kohë shumë të shkurtër. Braktisja e shkollës është përkeqësuar për shkak të krizës COVID-19, e manifestuar përmes shumë shkaqeve negative (Save the children, 2020).

Metodologjia

Qëllimi i punimit:

Ky punim synojn të analizojë vështirësitë dhe problematikat që hasën familjet rome dhe egjiptiane për të realizuar të drejtën për arsim gjatë periudhës së pandemisë. Përpos evidentimit të vështirësive përmes pyetjeve të përgatitura në pyetësorë apo intervista, punimi synon të nxjerrë në pah këto probleme për të gjetur zgjidhje për sigurimin e arsimit gjithpërfshirës, pavarësisht situatës së vështirë krijuar gjatë periudhës COVID-19.

Modeli konceptual

Modeli konceptual mbi të cilin u bazua punimi paraqitet në figurën 1.

Fig.1. ***Modeli konceptual***



Konteksti dhe pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit në këtë punë kërkimore janë 32 familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, përkatësisht 53 prindër dhe 122 fëmijë të grupmoshës 6-16 vjeç, të cilët banojë në banesat sociale në zonën Shkozë, Tiranë. Të dhënat demografike lidhur me strukturën e familjeve pjesëmarrëse, gjininë e fëmijëve dhe statusin e tyre ekonomik tregohen në grafikët A, A1 dhe A2.

Grafiku **A**.



Grafiku **A1**.



Grafku **A2**.



Konsiderata etike

Duke qenë se studimi parashikonte intervista dhe pyetësorë me fëmijë të moshës shkollore, autorja e studimit ka marrë paraprakisht lejen e prindërve të këtyre fëmijëve për të zhvilluar intervistat, duke shpjeguar edhe qëllimin e këtij studimi. Detyrimet ndaj pjesëmarrësve në punim u bënë të qarta përmes formularit të dhënies së pëlqimit, që u mor në konsideratë nga secili para plotësimit të pyetësorëve ose dhënies së intervistave. Formulari konsistoi ne këto tri pika:

1. Kuptoj se pjesëmarrja ime është vullnetare dhe kam të drejtën të tërhiqem në çdo kohë.
2. Konfirmoj se e kuptoj informacionin që më kërkohet dhe kam pasur mundësinë të bëj pyetje për sqarim.
3. Jap pëlqimin tim për pjesëmarrjen në këtë hulumtim.

Metoda

Për të mbledhur të dhëna lidhur me vështirësitë që prindërit dhe fëmijët e këtyre komuniteteve kanë hasur me mësimdhënien gjatë pandemisë COVID-19, u përdorën pyetësorë ose intervista gjysmë të strukturuara në varësi të aftësive për shkrim ose lexim që zotëronin pjesëmarrësit, me 5 pyetje të listuara si më poshtë:

1. Për familjet: A ka pasur raste në familjen tuaj kur fëmijët e kanë braktisur shkollën nga viti 2020 e më tej si shkak i pandemisë? (Nëse po tregohet numri i fëmijëve, gjinia dhe mosha e tyre.)

2. Për familjet: A ka pasur raste në familjen tuaj kur fëmijët nuk janë regjistruar në vitin shkollor 2020-2021 ose 2021-2022 si shkak i pandemisë? (Nëse po tregohet numri i fëmijëve dhe gjinia e tyre.)

3. Për familjet: A keni marrë ndihmë ligjore falas ose mbështetje të çfarëdo forme nga institucione apo organizata lidhur me arsimin (përmirësimin e frekuentimit të shkollës) gjatë periudhës së pandemisë?

4. Për prindërit: Ndjekjen e shkollës gjatë pandemisë e keni parë si problem apo si zgjidhje të problemeve?

5. Për fëmijët që kanë braktisur ose nuk janë regjistuar në shkollë: Sa dëshirë keni ju të ndiqni shkollën?
6. Për familjet: Cilat kanë qenë vështirësitë me të cilat jeni përballur gjatë pandemisë lidhur me arsimimin?

Analiza e të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave nga pyetësorët apo intervistat, të dhënat me karakter sasior u organizuan me ndihmën e programit kompjuterik SPSS, e më vonë u pasqyruan në grafikë me anë të Microsoft Exel. Referuar të dhënave me karakter cilësor, të gjitha argumentet u lexuan dhe u pasqyruan pa përsëritje dhe të përmbledhura.

Kufizimet e punës kërkimore

Pyetësori dhe intervistat patën në fokus vetëm banorët që jetojnë në zonën Shkozë në Tiranë dhe gjithashtu numri më i lartë i fëmijëve pjesëmarrës të grupmoshës 6-16 vjeç i përket gjinisë femërore.

Rezultatet

Referuar braktisjes së shkollës gjatë periudhës së pandemisë mbi dimensionin moshor dhe atë gjinor, rezultatet për fëmijë paraqiten në grafikët B1 dhe B2.

Grafiku **B1**.



Grafiku **B2**.





Referuar fëmijëve të paregjistuar në vitin shkollor 2020-2021 ose 2021-2022 mbi dimensionin gjinor, rezultatet për fëmijë paraqiten në grafikun C dhe C1.

Grafiku **C**.



Grafiku **C1**.



Referuar ndihmës ligjore falas ose mbështetjes të çfarëdo forme nga institucione apo organizata lidhur me arsimin gjatë pandemisë, pjesëmarrësve iu kërkua të jepnin përgjigje në këto forma : ‘Po’, ‘Po por nuk e pranuam’, ‘Jo’, ‘Nuk e di’, rezultatet për familje paraqiten në grafikun D.

Grafiku **D**.



Referuar pikëpamjeve të prindërve lidhur me ndjekjen e shkollës gjatë pandemisë si problem apo si zgjidhje të problemeve, rezultatet për prind paraqiten në grafikun E.

Grafiku **E**.



Referuar dëshirës për të ndjekur shkollën, fëmijët që e kanë braktisur atë ose nuk janë regjistruar si shkak i pandemisë, u përgjigjën në këto forma: ‘Fare’, ‘Pak’, ‘Disi’ dhe ‘Shumë’, rezultatet për fëmijë paraqiten në grafikun F.

Grafiku **F**.



Pikëpamjet e familjeve rome dhe egjiptiane mbi vështirësitë që hasën lidhur me arsimin gjatë pandemisë COVID-19 janë si më poshtë:

Pamjaftueshmëria ekonomike u theksua më shumë me ardhjen e pandemisë, ku shumë aktivitete me të cilat siguronin jetesën të tilla si: puna në tregun e rrobave të përdorura në Shkozë, puna si hamall, larja e xhamave të makinave, shitja në semaforë, shitja në kafene, shërbimet e pastrimit në vende parkimi, u bënë të pamundura e si rezultat e kishin të vështirë të siguronin ushqim për anëtarët e shumtë të familjes, ja përse arsimi për ta gjatë kësaj periudhe mbeti në fund të listës.

Pamundësi për t'u aksesuar në internet, ndonëse jetojnë në një zonë ku infrasruktura ua lejon, e kishin të pamudur të paguanin kompanitë që e ofronin këtë shërbim.

Pamundësi për t'u siguruar fëmijëve qoftë edhe pajisje të thjeshta elektronike për të ndjekur mësimin, si rrjedhojë e rënies së menjëhershme të ekonomisë e thellimit të varfërisë.

Infektimi me COVID-19 i një ose më shumë anëtarëve të familjes solli si domosdoshmëri ndihmën e fëmijëve për t'u kujdesur për njëri-tjetrin, një arsye më shumë për të braktisur shkollën.

Statusi i përkeqësuar ekonomik përgjatë kësaj periudhe përforcoi mendësitë e tyre negative mbi arsimin, sipas të cilëve është më mirë që vajzat të krijojnë herët familje e

djemtë të punojnë që në moshë të vogël për t'i kontribuar familjes në para, si strategji për të përballuar vështirësitë që iu shtuan me ardhjen e COVID-19.

Shumë prindërve të cilët kanë pak ose aspak arsimim dhe që ndihen vazhdimisht të paragjykuar e të diskriminuar pavarësisht punës që kanë apo atyre që zotërojnë, këto probleme që u shfaqën me ardhjen e pandemisë lidhur me ndjekjen e shkollës, u kthyen në barriera para së cilave u dorëzuan menjëherë pa kërkuar asnjë zgjidhje alternative.

Mungesa e ndihmave ose ndihma të pamjaftueshme nga institucionet përkatëse lidhur me përmirësimin e frekuentimit të shkollës gjatë pandemisë.

Ndjenja e inferioritetit të fëmijëve romë dhe egjiptianë të cilët ndihen të turpëruar të rikthehen në shkollë pasi e kanë braktisur atë gjatë pandemisë si shkak i moshës së rritur e pamundësive ekonomike.

Njohuritë e pamjaftueshme ose padija për të përdorur portalin e-Albania për të regjistruar fëmijët në klasë të parë për vitin shkollor 2021-2022.

Diskutime

Sfidat e hasura në arsimin onilne

Si hap i parë për të kuptuar suksesin ose dështimin e adaptimit shoqëror të nxënësve të pakicave dhe performancës akademike në shkollë, është njohja nga afër e këtyre grupeve, si dhe i faktorëve ndikues në mënyrën sesi ata e konceptojnë realitetin lidhur me modelin e tyre kulturor dhe në përshtatjen e tyre të përgjithshme me statusin e pakicës e me shkollimin (Ogbu, 1990). Në përputhje me këtë, qëllimi i këtij punimi ishte të nxirrte në pah e të analizonte vështirësitë që hasi komuniteti rom dhe egjiptian për t'u arsimuar gjatë periudhës kritike të Covid-19. Gjetjet që nxorri në pah ky punim theksojnë edhe njëherë problematikat e ndjeshme me të cilat përballet ky komununitet në procesin dinamik të mësimnxënies. Së pari, përfshirja e prindërve si pjesë kyç në pyetësorë dhe intervista, është në përputhje me atë çka Altschu (2012) thekson, duke qenë se përfshirja e tyre në arsim është përcaktuar në drejtim të investimit të burimeve që zotërojnë në edukimin e fëmijëve të tyre, dhe gjithashtu është detajuar në lidhje me sjelljet e prindërve, mbështetjen e tyre personale mbi arsimin dhe sigurimin e tyre gjatë procesit të edukimit

përmes investimit në burime financiare dhe personale. Së dyti, sipas Zaçellari & Miço (2020), zhvillimi i teknologjisë dhe rritja e globalizimit në arsim kërkojnë nga shtetet që të gjejnë mënyra inovative për të ofruar të drejtën për arsimim, e nga ana tjetër, krizat globale të tilla si pandemia nuk kanë qenë në axhendën ndërkombëtare, në mënyrë që të mendojnë dhe diskutojnë mënyrat e mundshme të realizimit të të njëjtave të drejta edhe në kushte të pazakonta. Ato theksojnë se një nga sfidat kryesore në ofrimin e mësimit online është disponueshmëria e tij për të gjitha shtresat shoqërore drejt përfshirjes në arsim, gjë që del në pah edhe nga rezultatet e përfturara nga ky punim, sipas të cilit arsimimi online në vendin tonë referuar kushteve të pandemisë Covid-19, rezultoi në mungesë të kapaciteteve dixhitale. Punimi mbështetet edhe nga një raportim i zhvilluar së fundmi në vendin tonë, i cili tregon se situata nën presionin e pandemisë Covid-19 u paraqit mjaft delikate për këto komunitete vulnerabël, që si rrjedhojë solli braktisje të shkollës nga ana e tyre në një masë të konsiderueshme (Save the children, 2020). Kësisoj përpos problemeve me karakter ekonomik a kulturor, punimi nxjerr në dritë vështirësitë lidhur me mësimin e zhvilluar online, me përdorimin e portalit e-Albania, ndihmat e pakta me në fokus frekuentimin e shkollës nga kjo pjesë e popullsisë, të cilat vijnë si një formë e dështimit të instancave shtetërore për të siguruar mirëinformim, për të mirëkrijuar strategji gjithëpërfshirëse në rrethana sfiduese dhe për të mundësuar siç duhet të drejtën bazë për arsimim.

Përfundime dhe Rekomandime

Procesi i mësimdhënies që prej marsit të vitit 2020 u realizua duke iu adaptuar kushteve të reja si shkak i pandemisë COVID-19, ama ky adaptim nuk u shfaq si fleksibël kundrejt grupeve vulnerabël si komuniteti rom dhe egjiptian, të cilët u përballën më një sërë vështirësish lidhur me arsimin gjatë kësaj periudhe. Nga rezultatet e marra nga pyetësorët ose intervistat u vu re se shumë fëmijë braktisën shkollën që nga viti 2020 e më pas, disa mbetën të paregjistuar në vitin shkollor 2020-2021 dhe 2021-2022, shumë familje nuk morën ndihma nga institucionet përkatëse lidhur me frekuentimin e shkollës gjatë kësaj periudhe, një pjesë e madhe e prindërve e shohin arsimimin e fëmijëve si problematik dhe shumica e fëmijëve që kanë braktisur ose nuk ndjekin shkollën kanë aspirata të ulëta lidhur me pjesëmarrjen në të. Si rrjedhojë punimi nxorri në pah problematikat lidhur me

sigurimin e mjeteve të nevojshme për arsim gjatë kësaj periudhe, probleme në përdorimin e portalit e-Albania e gjithashtu përforcimin e mungesës së besimit në arsimim dhe në institucinet vendore.

Për këto arsye rekomandojmë që:

Grupet vulnerabël si komuniteti rom dhe egjiptian të konsiderohen të rëndësishëm kur krijohen strategji dhe politika për mësimdhënien në varësi të ndryshimit të rrethanave, duke krijuar kushte dhe duke gjetur mënyra inovative për të promovuar mundësi të barabarta për realizimin e të drejtës për arsim.

Mekanizmat për mbrojtjen sociale të instancave shtetërore të hartojnë programe më specifike për të adresuar dhe trajtuar çështjet problematike, duke marrë parasysh natyrën e pengesave gjatë pandemisë, për t'i ardhur në ndihmë në një masë më të plotë dhe në mënyrë më efektive këtyre komuniteteve.

T'u mundësohen anëtarëve të këtyre komuniteteve programe për aksesimin dhe përdorimin në platformën e-Albania, si platformë kyç në regjistrimin e fëmijëve në shkollë për vitin 2021-2022.

Shkollat të përmbushin synimin për të ofruar arsim multikulturor duke promovuar vlera përmes organizimeve që kanë si temë kulturën e këtyre komuniteteve për ta bërë të njohur në masë më të gjerë, për të rritur integrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, e për të demostruar barazinë, si barriera penguese kundrejt diskriminimit.

Të hartohen programe për edukimin e prindërve lidhur me integrimin social të fëmijëve të tyre në shkollë, për të mposhtur mendësitë negative lidhur me arsimin.

Bibliografia

Kao, G., & Tienda, M. (1998). Educational Aspirations of Minority Youth. American Journal of Education, 106(3), 349–376. Retrieved September 3, 2021, from http://www.jstor.org/stable/1085583

Kao, G., & Thompson, J. S. (2003). Racial and Ethnic Stratification in Educational Achievement and Attainment. Annual Review of Sociology, 29, 419-431. Retrieved September 5, 2021, from http://www.jstor.org/stable/30036974

Ripke, M. N., & Crosby, D. A. (2002). The Effects of Welfare Reform on the Educational Outcomes of Parents and Their Children. Review of Research in Education, 26, 182. Retrieved September 3, 2021, from http://www.jstor.org/stable/3568145

Thompson, E. G. (2010). Addressing Institutional Structural Barriers to Student Achievement. Race, Gender & Class, 17(1/2), 51–55. Retrieved September 6, 2021, from http://www.jstor.org/stable/41674724

Mercat-Bruns, M., Holt, E., & Kutz, C. (2016). The Multiple Grounds of Discrimination. In Discrimination at Work: Comparing European, French, and American Law, 157. University of California Press. Retrieved September 12, 2021, from http://www.jstor.org/stable/10.1525/j.ctt1ffjn61.10

Matthew, D. C. (2017). Racial Injustice, Racial Discrimination, and Racism: How Are They Related? Social Theory and Practice, 43(4), 885–887. Retrieved September 12, 2021, from http://www.jstor.org/stable/26405310

Prins, E., & Toso, B. W. (2008). Defining and Measuring Parenting for Educational Success: A Critical Discourse Analysis of the Parent Education Profile. American Educational Research Journal, 45(3), 556–565. Retrieved September 10, 2021, from http://www.jstor.org/stable/27667144

Grant, M. J., & Hallman, K. K. (2008). Pregnancy-Related School Dropout and Prior School Performance in KwaZulu-Natal, South Africa. Studies in Family Planning, *39*(4), 370. Retrieved September 9, 2021, from http://www.jstor.org/stable/20454482

EWERT, S., SYKES, B. L., & PETTIT, B. (2014). The Degree of Disadvantage: Incarceration and Inequality in Education. The Annals of the American Academy of Political and Social Science, 651, 27. Retrieved September 11, 2021, from http://www.jstor.org/stable/24541692

Stevens, M. L. (2008). Culture and Education. The Annals of the American Academy of Political and Social Science, 619, 97. Retrieved September 11, 2021, from http://www.jstor.org/stable/40375797

Altschul, I. (2012). Linking Socioeconomic Status to the Academic Achievement of Mexican American Youth Through Parent Involvement in Education. Journal of the Society for Social Work and Research, 3(1), 13–18. Retrieved September 5, 2021, from https://doi.org/10.5243/jsswr.2012.2

Ogbu, J. U. (1990). Minority Education in Comparative Perspective. The Journal of Negro Education, 59(1), 45–55. Retrieved September 9, 2021, from https://doi.org/10.2307/2295291

Rega, V. (2016). Panorami di scienze umane: antropologia, sociologia, metodologia della ricerca, 455-462. Rome. Zanichelli.

Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës. (2017-2020). CDP-Tirane_final.pdf (idmalbania.org), 39-69. Retrieved September 6, 2021, from https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2018/07/CDP-Tirane_final.pdf

Zaçellari, M. Mico, H. (2020). Online learning as a means toward achieving an adaptable right to education on Albania, 42(2), 293–296. Retrieved September 5, 2021, from https://ikm.mk/ojs/index.php/KIJ/article/view/4672

Zaçellari, M. Mico, H. Sinitsa, I. (2018). Inclusive education for Roma children in Albania and Belarus: legal situation, accessibility, opportunities to learn in own language and support of ethnic identity, 1, 195–201. Retrieved September 4, 2021, from https://sciendo.com/article/10.2478/poljes-2018-0016

Save the Children. (2020). NEED ASSESSMENT for the situation created in Albanian communities as result of COVID 19, 51-52. Retrieved September 4, 2021, from https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Assessment%20Report%20on%20the%20effects%20of%20covid%2019%20to%20community.pdf